



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT OSMANAJ



Tiranë, më 20.11.2023

Nr. 795/3 Dosje

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE.

Per dijeni:

Debitorit: Shoqeria "EKMA Albania" sh.p.k, Administrator Z.Klodian ALLAJBEU.

Adresa: (Kashar), Ish Ndërmarrja e Karburanteve (Tregu Agro-Ushqimor), Km. 1 i Autostrades Tirane – Durres, Tirane. Kapanoni F Kati i Dyte.

Per dijeni: Autoriteti i Konkurrences.

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë.

Unë, Euglent OSMANAJ, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 2197 Regj të lëshuar më datë 18.12.2018 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tirane kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 795, Datë 26.10.2023 kërkesën e kreditorit "Autoriteti i Konkurrences" ndaj debitorit Shoqeria "EKMA Albania" sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendimin Nr.572, date 22.11.2018 të Autoritetit të Konkurrences".

Pasi është filluar procesi i ekzekutimit të detyrueshëm, debitorit i është dërguar Lajmërimi Nr.795 Dosje, Datë 02.11.2023 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.2197 Regj, date 18.12.2018 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Adresa:Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8, Njesia 10, Tirane.

Email:euglentosmanaj@yahoo.com

Cel:069 74 90 508

KONSTATOVA Se :

Debitori Shoqeria Shoqeria "EKMA Albania" sh.p.k sh.p.k ka marre dijani per detyrimin dhe nuk e ka permbushur ate brenda afatit te lajmerimit per ekzekutim vullnetar

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqeria "EKMA Albania" sh.p.k, me Nipt , K91616015F, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në këto kushte, referuar nenit 519, 527 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Venien e mases se sekuestros konservative mbi aktivet e debitorit Shoqeria "EKMA Albania" sh.p.k, me Nipt K91616015F , deri ne nje urdher te dyte te permbaruesit gjyqesor.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijani.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Euglent OSMANAJ



Adresa:Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane.
Email:euglentosmanaj@yahoo.com
Cel:069 74 90 508